

L I G J
Nr. 7908, datë 5.4.1995

PËR PESHKIMIN DHE AKUAKULTURËN
(Ndryshuar me ligjet nr. 8763, datë 2.4.2001; nr. 8870, 21.3.2002; nr. 10 001, datë 6.10.2008)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Sfera e zbatimit të ligjit

Ky ligj zbatohet në veprimtarinë e peshkimit dhe të akuakulturës që ushtrohet në ujërat dhe territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Objekti
(Ndryshuar shkronja "b" dhe shtuar shkronja "dh" me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

Dispozitat e këtij ligji kanë për qëllim:

- a) të sigurojnë një shfrytëzim racional dhe të përgjegjshëm të resurseve biologjike ujore dhe zhvillimin e akuakulturës;
- b) Të organizojë menaxhimin në sektorët e peshkimit dhe të akuakulturës nëpërmjet përfshirjes së komuniteteve të peshkimit në proceset e vendimmarrjes dhe të bashkëmenaxhimit të burimeve të peshkimit;
- c) të sigurojnë masat e ruajtjes (konservimit) për të garantuar tutelën e resurseve biologjike ujore;
- ç) të sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, si dhe kushte të mira socialekonomike për prodhuesit;
- d) të sigurojnë kërkesat e konsumatorit për futjen në treg të prodhimeve iktike të përshtatshme për konsum njerëzor;
- dh) të nxitin e ndikojnë në kërkimin shkencor e teknologjik në sektorët e peshkimit dhe të akuakulturës.
- e) Të sigurojë funksionimin dhe menaxhimin e porteve dhe të qendrave të peshkimit.

Neni 3
Përkufizime
(Shtuar shkronjat “gj”, “h”, “i”, “j”, “k” me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

Në kuptim të këtij ligji dhe për aktet nënligjore për zbatimin e tij:

a) në ujëra të Republikës së Shqipërisë “përfshihen ujërat detare territoriale dhe çdo zonë tjetër detare e rezervuar ekskluzivisht për Republikën e Shqipërisë, në bazë të ligjit e të së drejtës ndërkombëtare, sikurse edhe lumenjtë, liqenet, lagunat, banesat hidrografike dhe ujërat e tjera që ndodhen në territorin e Republikës;

b) me “peshkim” kuptohet çdo veprimtari e drejtuar për zënien ose grumbullimin e organizmave ujorë, përveç atyre që rezultojnë nga veprimtaritë e akuakulturës, pavarësisht nga mjetet e përdorura dhe synimet e arritura;

c) me “peshkim profesional” kuptohet peshkimi që kryhet kryesisht për qëllime të shfrytëzimit ekonomik, dhe me “peshkim sportiv” kuptohet peshkimi që kryhet për qëllime çlodhëse e dëfruese;

ç) me “akuakulturë” kuptohet mbarështimi (kultivimi) i organizmave ujorë, i drejtuar për shfrytëzimin e tyre ekonomik;

d) me “organizma ujorë” kuptohen organizmat e gjallë ose jo, shtazorë a bimorë, të ngrënshëm a të pangrënshëm që kanë ujin si mjedis të zakonshëm ose natyror jetese, ku përfshihen peshqit, krustcete, molusket, koralet, sfungjerët, amfibët, reptilët ujorë (maniferët) gjitarët ujorë, si dhe vezët, lavrat e rasatet e tyre ose prodhime të tjera natyrore, me përjashtim të shpendëve;

dh) me “mjet lundrues” kuptohet çdo lloj anije (barkë) ose galexhant tjetër i përshtatshëm për lundrim;

e) me “mjet lundrues shqiptar” kuptohet çdo lloj mjeti lundrues në pronësi të:

- një personi fizik me shtetësi shqiptare dhe me banim në Shqipëri;

- një personi juridik, krijuar në republikën e Shqipërisë sipas ligjeve në fuqi;

- një enti të ndryshëm nga një person juridik, ku përfshihen ekskluzivisht persona fizikë me shtetësi shqiptare dhe me banim në Shqipëri;

dhe e regjistruar në Shqipëri sipas ligjeve e rregullave në fuqi;

ë) me “mjet lundrues të huaj” kuptohet çdo mjet lundrues i ndryshëm nga ai i përcaktuar në gërmën “e”;

f) me “subjekt të huaj” kuptohet çdo person fizik me shtetësi jo shqiptare ose person juridik që është themeluar sipas ligjit të një vendi të huaj;

g) me “ministri” dhe “ministër” kuptohet përkatësisht ministri dhe Ministria që ka në varësi sektorin e peshkimit dhe të akuakulturës.

gj) Me "Organizatë" kuptohet Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, e krijuar sipas nenit 26 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 31/1 të këtij ligji;

h) Me "Port peshkimi" kuptohet një port ose liman që përdoret për peshkim, përfshirë edhe sjelljen në tokë nga mjetet e lundrimit të organizmave ujorë, apo një zonë e përcaktuar brenda një porti tregtar, që përdoret për qëllime të tilla, së bashku me tokën, ndërtesat dhe strukturën përkatëse.

i) Me "Qendër peshkimi" kuptohet një mol, steré, urë në det, valëpritëse ose bankinë, në det ose në ujërat e brendshme, që përdoret për qëllime peshkimi, përfshirë edhe sjelljen në tokë nga mjetet lundruese të organizmave ujorë, së bashku me tokën, ndërtesat dhe strukturat përkatëse.

j) Me "Zonë bashkëmenaxhimi" kuptohet një zonë e peshkimit, e caktuar sipas nenit 31/14 të këtij ligji, ku të paktën një organizatë e menaxhimit të peshkimit merr pjesë në menaxhimin e burimeve të peshkimit.

k) Me "Plan bashkëmenaxhimi" kuptohet një plan për menaxhimin e zonës së bashkëmenaxhimit të peshkimit, që përgatitet në përputhje me dispozitat e pikës 3 të nenit 31/15 të këtij ligji.

KREU II ORGANET KONSULTATIVE

Neni 4

Komisioni konsultativ qendror për peshkimin dhe akuakulturën

1. Pranë Ministrisë ngrihet Komisioni konsultativ qendror për peshkimin dhe akuakulturën, si organ konsultativ i ministrit në lëmin e peshkimit dhe të akuakulturës.

2. Tërheqja e mendimit të Komisionit është e detyrueshme për problemet që lidhen me shqyrtimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore të peshkimit e akuakulturës dhe propozimet për ndryshime të mundshme të tyre, si dhe me përshtatjen e planeve të peshkimit (neni 8, 9, 10).

Neni 5

Përbërja e Komisionit konsultativ qendror për peshkimin dhe akuakulturën

1. Komisioni konsultativ qendror për peshkimin dhe akuakulturën kryesohet nga ministri, ka në përbërje përfaqësues të Drejtorisë së peshkimit, të drejtorive të tjera të ministrisë e të ministrive të tjera të interesuara, si dhe përfaqësues të veprimtarive prodhuese dhe eksperte në lëmin e peshkimit e të akuakulturës.

2. Anëtarët e Komisionit caktohen nga ministri për një afat trevjeçar.

3. Drejtori i Drejtorisë së peshkimit pranë ministrisë kryen funksionet e nënkryetarit të Komisionit, kurse një funksionar i po kësaj drejtorie kryen funksionet e sekretarit.

Neni 6

Komisionet konsultative lokale për peshkimin dhe akuakulturën

1. Pranë autoriteteve administrative lokale, atje ku shihet e nevojshme, krijohen komisionet konsultative lokale për peshkimin dhe akuakulturën.

2. Komisionet lokale japin mendimet për çështjet e peshkimit dhe akuakulturës në njësitë e tyre administrative, sa herë që ministri ose Komisioni konsultativ qendror e konsiderojnë të nevojshme.

3. Ministri vendos për lokalizimin e komisioneve lokale, përcakton përbërjen e tyre, si dhe emëron kryetarin e çdo komisioni.

Neni 7

Komisioni për koordinimin e kërkimit shkencor dhe teknologjik

1. Pranë ministrisë krijohet komisioni për koordinimin e kërkimit shkencor e teknologjik të aplikuar në peshkim dhe akuakulturë.

Anëtarët e komisionit caktohen nga ministri.

2. Komisioni jep mendime për çështje që lidhen me studimet e kërkimet me interes shkencor, teknik, statik dhe ekonomik për peshkimin e akuakulturën.

KREU III NORMAT E PROGRAMIMIT

Neni 8

Plani i administrimit të peshkimit dhe akuakulturës

Plani i administrimit të peshkimit dhe akuakulturës përshtatet (rishikohet) periodikisht

dhe përmirësohet në përputhje me normat e këtij ligji.

Ky plan përpunohet e përgatitet nga Drejtoria e peshkimit pranë ministrisë, merret pëlqimi i Komisionit qendror për peshkimin dhe akuakulturën dhe miratohet nga ministri.

Neni 9

Plani i zhvillimit të peshkimit dhe akuakulturës

Plani i zhvillimit të peshkimit dhe akuakulturës është objekt i veçantë i buxhetit të shtetit.

KREU IV

KËRKIMI SHKENCOR

Neni 10

Autorizimi për kërkimin

Veprimtaria kërkimore në lëmin e peshkimit dhe të akuakulturës në ujërat e Republikës së Shqipërisë bëhet me autorizimin e ministrisë mbi bazën e mendimit të komisionit për koordinimin e kërkimit shkencor dhe teknologjik.

Neni 11

Entet e njohura të kërkimit

1. Ministria mund të njohë si ent kërkimi çfarëdo subjekt privat që bën kërkesën, në bazë të verifikimit të kualifikimit dhe kapacitetit të tyre.

KREU V

TË USHTRUARIT E VEPRIMTARISË SË PESHKIMIT

Neni 12

Regjistri i peshkatarëve profesionistë

Ministria krijon një regjistër të peshkatarëve profesionistë pranë zyrave të përcaktuara prej saj dhe cildo që kërkon të zhvillojë veprimtarinë e peshkimit profesional, detyrohet të bëjë regjistrimin me regjistrin e peshkatarëve profesionistë, atestohet dhe pajiset me certifikatën përkatëse.

Neni 13

Regjistri i mjeteve lundruese të peshkimit

1. Ministria krijon një regjistër të mjeteve lundruese të peshkimit pranë zyrave ose organeve të përcaktuara prej saj.

2. Çfarëdolloj mjeti lundrues që përdoret për peshkim profesional, duhet të regjistrohet në regjistrin e mjeteve lundruese të peshkimit.

Neni 14

Rregullimi i pragut të peshkimit

(Shtuar fjali në pikën 1 me ligjin nr. 8870, 21.3.2002; ndryshuar me ligjin nr. 10 001, datë 6.10.2008)

Numri maksimal i licencave të peshkimit detar përcaktohet nga ministria, sipas planit

të administrimit të peshkimit.

Neni 15

Licenca e peshkimit profesional

(Shtuar togfjalësh në pikën 1 me ligjin nr. 8870, 21.3.2002; ndryshuar pika 1 dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 10 001, datë 6.10.2008)

1. Çdo mjet lundrues, që përdoret për peshkim profesional, pajiset me licencën përkatëse, e cila lëshohet nga ministri, pas miratimit nga bordi i peshkimit, në bazë të kërkesës për ushtrim veprimtarie.

2. Shfuqizuar.

3. Zotërimi i mjeteve lundruese të peshkimit nuk përbën kusht të mjaftueshëm për të fituar të drejtën e pajisjeve me një licencë të peshkimit profesional.

Neni 16

Kushtet dhe kohëzgjatja e licencës së peshkimit profesional

1. Në lëshimin dhe rinovimin e licencës së peshkimit profesional ministria mund të imponojë kushte për secilën nga pikat e mëposhtme:

a) zona ku do të zhvillohet veprimtaria;

b) pajisjet e peshkimit që mund të përdoren;

c) paraqitja e informacioneve dhe e të dhënave statistikore;

ç) detyrimi për të lejuar praninë dhe qëndrimin e vrojtuesve të caktuar nga ministria në bordin e anijes për qëllime të grumbullimit të të dhënave të ndryshme për peshkimin.

2. Licenca e peshkimit profesional ka një kohëzgjatje të specifikuar, sipas akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji. Kohëzgjatja duhet të jetë e shënuar në licencë.

3. Peshkimi jashtë ujërave të republikës së Shqipërisë bëhet me autorizim të veçantë.

4. Licencat e peshkimit profesional, të vlefshme në bazë të dispozitave ekzistuese në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbeten të tilla deri në afatin e skadimit të tyre.

5. Mjetet e peshkimit shqiptare të pajisura me licencë të peshkimit profesional punësojnë ekuipazh të përbërë nga shtetas shqiptarë. Prania e ekspertëve të veçantë të huaj, në bordin e mjetit të peshkimit autorizohet nga Ministria.

Neni 17

Licencat për veprimtaritë e lidhura me peshkimin

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10 001, datë 6.10.2008)

Neni 18

Marrëveshje për peshkim

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë lidh marrëveshje me qeveritë e vendeve të tjera ose me organizma ndërkombëtarë në fushën e peshkimit. Marrëveshjet përmbajnë tregues për licencat e peshkimit ose për veprimtaritë e lidhura me të.

2. Marrëveshjet mbi bazën e këtij neni duhet të përcaktojnë detyrimet e palës tjetër për të garantuar respektimin e normave që zbatohen në peshkim në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19

Licenca e peshkimit për mjetet lundruese të huaja ose për veprimtari të lidhura me peshkimin për subjektet e huaja

(Shtuar pika 4 me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Ministria lëshon licencë për peshkimin ose për ushtrimin e veprimtarive që lidhen me të mjeteve lundruese ose subjekteve të huaja vetëm:

a) në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare në fuqi me shtetin që i përket mjeti lundrues a subjekti i huaj; ose

b) në rastin kur lëshimi i licencës;

- quhet i dobishëm për ekonominë e Republikës së Shqipërisë dhe veçanërisht kur kërkuesi i kësaj licence merr përsipër për të bërë investime të dobishme në sektorin e peshkimit në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikën dhe strategjinë e përcaktuar për zhvillimin e këtij sektori;

- është i nevojshëm për shfrytëzimin optimal të resurseve, duke pasur parasysh kapacitetet kombëtare për peshkimin dhe zhvillimin e tyre;

- të jetë në përputhje me politikën e Republikës së Shqipërisë në lidhje me investimet e huaja dhe në mënyrë të veçantë me parashikimet e planit të administrimit të peshkimit dhe akuakulturës.

2. Zotëruesi i një licence të lëshuar mbi bazën e këtij ligji, është subjekt që mbrohet nga legjislacioni i peshkimit dhe nga aktivitetet e lidhura me peshkimin, që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Zotëruesi i një licence, të lëshuar mbi bazën e këtij neni, duhet të jetë paraprakisht i njohur nga shteti përkatës dhe shteti ynë si person juridik.

4. Licenca e peshkimit në një zonë bashkëmenaxhimi duhet të jetë në përputhje me përmbajtjen e planit përkatës të bashkëmenaxhimit.

Neni 20

Ndalohet dhënia e licencës mjeteve lundruese të huaja për peshkimin fundor (demersal) me trata tërheqëse (trata koce) dhe peshkimin e grumbullimin e moluskeve bivalvore (dykapakore).

Neni 21

Detyrimi për t'u kthyer në një port shqiptar

Çdo mjet lundrues shqiptarë a e huaj, e pajisur me licencë për peshkimin profesional në ujërat e Republikës së Shqipërisë, është i detyruar të kthehet pranë një porti shqiptar pas veprimtarisë së peshkimit dhe para eksportit të mundshëm të organizmave ujorë të peshkuar, për të kryer gjithë veprimet e kërkuara sipas ligjeve në fuqi.

Neni 22

Peshkimi i koraleve dhe i sfungjerëve

1. Ndalohet peshkimi i koraleve dhe i sfungjereve. Për qëllime studimore e kërkimore ministri lëshon autorizim të veçantë.

Neni 23

Peshkimi sportiv

(Shtuar shkronjat “dh”, “e” me ligjin nr. 8870, 21.3.2002; ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 10 001, datë 6.10.2008)

1. Peshkimi sportiv ushtrohet pa licencë.

2. Peshkimi sportiv është i ndaluar:

- a) kur përdoren mjete lundruese të ndryshme nga ato që përcaktohen me aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji;
- b) kur përdoren pajisje tipike të peshkimit profesional, ose të ndryshme nga ato që përcaktohen në aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji;
- c) në zona që nuk janë të lejuara për peshkimin sportiv nëpërmjet akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji;
- ç) kur përdoren pushkë nënujore në një largësi më të vogël se 50 metra nga pajisjet e peshkimit profesional;
- d) kur përdoren pushkë nënujore për mosha nën gjashtëmbëdhjetë veç;
- dh) kur përdoren pushkë nënujore, me pajisjet përkatëse, që sigurojnë frymëmarrjen nën ujë.
- e) në zonat e mbrojtura detare.

Neni 24 Ndalimet

1. Ndalohet:
 - a) të peshkohet
 - në zona e periudha të ndaluara nga aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji;
 - me mjete lundruese, pajisje fikse ose të lëvizshme të ndaluara nga aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji;
 - organizmat ujorë të llojeve të ndaluara nga aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, për qëllime të mbrojtjes së tyre ose për motive të tjera;
 - organizmat ujorë me dimensione të ndaluara nga aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji;
 - në sasi më të mëdha se ato që eventualisht fiksohen si sasi maksimale nga aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji;
 - vezët, lavrat e të vegjëlit e çdo lloj organizmi ujor, pa autorizimin e nevojshëm ose licencën e lëshuar në bazë të akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji;
 - b) përdorimi i lëndëve eksplozive, kimike e helmuese, i energjisë elektrike, të afta të trullosin, paralajmërojnë ose vrasin organizmat ujorë, edhe në kuadrin e veprimtarisë së akuakulturës;
 - c) të peshkohen organizmat ujorë që janë objekt peshkimi i të tretëve, si dhe të peshkohet në largësi më të vogla se ato të parashikuara nëpërmjet akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji nga pajisjet e mjetet e peshkimit të të tretëve, pa konsensusin e përfituesit sipas ligjit;
 - ç) të mbahen, transportohen e tregtohen çfarëdolloj organizmash ujorë të përfituara në kundërshtim me këtë ligj dhe me aktet nënligjore që rrjedhin prej tij;
 - d) të ndryshohet cilësia e ujërave dhe drejtimi i rrjedhës së tyre, në mënyrë të tillë që mund të dëmtohet habitat i organizmave ujorë ose impiantet e akuakulturës, përveç rasteve të autorizuara sipas ligjit.
2. Ndalimet e lartpërmendura nuk janë të vlefshme për rastet e parashikuara në nenin 11, pika 5.

Neni 25 Detyrimi për paraqitjen e të dhënave (Hequr fjalë me ligjin nr. 10 001, datë 6.10.2008)

Zotëruesi i një licence të peshkimit profesional si dhe i aktivitetit të akuakulturës, është i detyruar të japë me përgjegjësi të dhënat statistikore që lidhen me veprimtarinë e zhvilluar, sipas mënyrave e kriterëve që përcaktohen me aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 26

Autorizimi për futjen e organizmave ujorë dhe për eksportin e importin e të vegjëlve
(Ndryshuar me ligjin nr. 10 001, datë 6.10.2008)

Cilido, që kërkon të fusë organizma ujorë të gjallë dhe vezë, larva ose rasate të specieve joendemike, në ujërat e Republikës së Shqipërisë, pajiset me leje ose autorizim mjedisor.

KREU VI
TË USHTRUARIT E VEPRIMTARISË SË AKUAKULTURËS

Neni 27

Veprimtaria e akuakulturës

(Shtuar pika 6/1 me ligjin nr. 8763, datë 2.4.2001; ndryshuar me ligjin nr. 10 001, datë 6.10.2008)

1. Veprimtaria e akuakulturës zhvillohet nga subjektet fizike ose juridike, të cilat kanë objekt të veprimtarisë akuakulturën. Personat fizikë ose juridikë, të interesuar për zhvillimin e akuakulturës, tokësore dhe ujore, në pronat publike, u nënshtrohen procedurave të konkurrimit publik. Me fituesin, ministria ose përfaqësuesi i pronës shtetërore lidh kontratë qiraje. Procedurat për lidhjen e kontratës dhe ato të konkurrimit publik nuk zbatohen në rastet kur toka është në pronësi private.

2. Kontrata e qirasë lidhet vetëm kur zbatimi i projektit ndikon në zhvillimin e ekonomisë shqiptare dhe nuk shkakton efekte negative në mjedis. Personat fizikë ose juridikë, të interesuar për zhvillimin e veprimtarisë së akuakulturës, pajisen me leje ose autorizim mjedisor.

3. E drejta e përdorimit të tokave, në pronësi shtetërore, për zhvillimin e veprimtarisë së akuakulturës, përcaktohet në kontratë, pasi merret, për territorin në fjalë, edhe mendimi i organeve përkatëse.

4. E drejta e përdorimit të sipërfaqeve ujore të Republikës së Shqipërisë për zhvillimin e veprimtarisë së akuakulturës përcaktohet në kontratën e qirasë.

5. Sipërfaqet ujore të Republikës së Shqipërisë u jepen me qira personave juridikë e fizikë, për të ushtruar veprimtarinë e akuakulturës intensive, me synim shfrytëzimin e këtyre sipërfaqeve, në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Procedurat dhe vlerat e qirasë, sipas kategorive ujore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Në kontratën e qirasë, për rastet e përcaktuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, jepen dhe kushtet e qirasë, përveç rasteve kur kjo është e parashikuar nga ligjet në fuqi. Vlerësimi i tokave shtetërore për qëllime të akuakulturës klasifikohet në një kategori me tokat bujqësore, sipas ligjeve në fuqi.

Neni 28

Kushtet e ushtrimit të veprimtarisë së akuakulturës

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 001, datë 6.10.2008)

Në ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës, ministria mund të vendosë kushte për secilën nga pikat e mëposhtme:

- a) struktura, pajisjet dhe mirëmbajtja e impianteve;
- b) zonat ku do të zhvillohet veprimtaria;

- c) sasia dhe cilësia e ushqimeve që do të përdoren;
- ç) përdorimi i lëndëve kimike;
- d) mbajtja e regjistrave dhe paraqitja e informacioneve;
- dh) sinjalizimi i sëmundjeve që shfaqen;
- e) sasia, cilësia dhe llojet e të vegjëlve që mund të futen e përdoren;
- ë) shkarkimi i çfarëdo lloj materiali nga impiantet;
- f) kontrolli i cilësisë së ujit;
- g) transporti i peshkut;
- gj) domosdoshmëria e një licence të veçantë për veprimtaritë e lidhura me akuakulturën;
- h) kufizimi i zonës ku do të zhvillohet veprimtaria;
- i) sigurimet e detyrueshme.

Neni 29

Kohëzgjatja e kontratës

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 001, datë 6.10.2008)

1. Kohëzgjatja e kontratave për sipërfaqet tokësore është deri në 20 vjet dhe për sipërfaqet ujore deri në 10 vjet. Pas mbarimit të afatit ato mund të rinovohen.

2. Në kontratë parashikohen afatet, brenda të cilave duhet të fillojnë e të përfundojnë veprat për ushtrimin e veprimtarisë. Në çdo rast, veprat duhet të përfundohen brenda tre vjetëve nga çasti i nënshkrimit të kontratës.

Neni 30

Modifikimet

Çdo modifikim i strukturave, pajisjeve dhe mirëmbajtjes së impianteve duhet të autorizohet paraprakisht nga ministria.

KREU VII

PESHKIMI NË LAGUNAT BREGDETARE DHE NË UJËRAT E BRENDSHME

(Ndryshuar titulli i Kreut me ligjin nr. 10 001, datë 6.10.2008)

Neni 31

Marrëveshjet për administrimin

(Shtuar paragraf në pikën 1 me ligjin nr. 8870, 21.3.2002; shtuar pika 6 me ligjin nr. 10 001, datë 6.10.2008)

1. Ministria përfundon marrëveshje me subjekte publike e private për administrimin e lagunave ose zonave të tjera të ujërave të Republikës së Shqipërisë, eventualisht edhe për zona limitrofe, me qëllim që të ruhet ekuilibri ekologjik dhe shfrytëzimi racional i resurseve peshkore të këtyre zonave.

Marrëveshje nuk bëhen për zonat gjeografike, që janë miratuar si zona bashkëmenaxhimi, sipas të njëjtës formë të veprimtarisë së peshkimit.

2. Marrëveshjet shoqërohen me një plan për administrimin e zonës, ku specifikohet gjendja e resurseve dhe objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij administri, të gjitha kushtet për zbatimin e tij, veçanërisht:

a) përcaktimi dhe kufizimi i zonës ujore ose limitrofe, për të cilën do të bëhet marrëveshja;

b) kohëzgjatja e marrëveshjes;

c) përcaktimi në veçanti i detyrimeve që ndërmerr pala kontraktuese, si ndërtimi i

infrastrukturave ekzistuese, si dhe pagesat vjetore;

ç) garancitë që ofron pala kontraktuese për respektimin e detyrimeve të veta;

d) të drejtat që fiton pala kontraktuese për secilin nga resurset e zonës, si për resurset peshkore e faunistike, ashtu edhe për zhvillimin e veprimtarisë së akuakulturës;

dh) masat që përcaktohen për të siguruar respektimin e së drejtës së peshkimit dhe të veprimtarive të tjera, që tradicionalisht ushtrohen në atë zonë;

e) detyrimet që merr Ministria në lidhje me administrimin e zonës;

ë) pasojat në rastet e shkeljeve të dispozitave të marrëveshjes nga secila palë.

3. Projekti i një marrëveshje, në bazë të këtij neni, duhet të publikohet dhe në mënyrë të veçantë t'u bëhet i njohur rezidentëve të zonës dhe autoriteteve lokale me mjete të përshtatshme nëpërmjet afishimit në vende publike, publikimi në shtyp e mjeteve të tjera të informacionit, në mënyrë që subjektet e interesuara të japin mendimet dhe vërejtjet e tyre.

4. Afati i publikimit nuk duhet të jetë më pak se tridhjetë ditë.

5. Vërejtjet që do të jepen nga cilido në lidhje me projekt-marrëveshjen në fjalë, duhet të shikohen e vlerësohen nga Ministria para përfundimit të marrëveshjes. Vendimi që do të merret, duhet të jetë i motivuar dhe të publikohet.

6. Për ujërat e brendshme, e drejta e peshkimit fitohet nëpërmjet konkurrimit publik. Në ato kategori ujore, të shpallura si zona bashkëmenaxhimi, ku ekzistojnë organizatat e menaxhimit të peshkimit (OMP), kontrata lidhet me OMP-në, e cila pajis anëtarët e vet peshkatarë me dokumentacionin përkatës të anëtarësisë.

KREU VII/I

ORGANIZATAT E MENAXHIMIT TË PESHKIMIT

(Shtuar Kreu me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

Neni 31/1

Organizatat e menaxhimit të peshkimit

(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Organizatat e menaxhimit të peshkimit janë persona juridikë, privatë, që krijohen në mbështetje të nenit 26 të Kodit Civil, për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e peshkimit, në përputhje me përcaktimet e parashikuara në këtë ligj. Organizatat e menaxhimit të peshkimit kanë buxhet të pavarur, që bazohet në kuotat e anëtarësisë, donacionet e ndryshme, si dhe nga çdo e ardhur, që realizohet nga veprimtaria e tyre, e parashikuar nga ky ligj. Çdo e ardhur shtesë mbi shpenzimet nuk do të shpërndahet ndërmjet anëtarëve të organizatës, por do të përdoret për realizimin e objektivave të saj.

2. Mbledhja e themelimit miraton statutin e organizatës, mbështetur në statutin tip, dhe zgjedh organet drejtuese të saj. Të paktën gjysma e anëtarëve pronarë, që marrin pjesë në mbledhjen e themelimit, duhet të shprehen dakord me statutin. Projektstatuti i organizatës miratohet nga ministri. Urdhri për miratimin e statutit, së bashku me një kopje të statutit, botohen në Fletoren Zyrtare.

3. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit fiton status juridik pas botimit në Fletoren Zyrtare të urdhrit të ministrit për miratimin e statutit të saj.

4. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit:

a) do të menaxhojë një port ose qendër peshkimi sipas kreut VII/II të këtij ligji;

b) do të marrë pjesë në bashkëmenaxhimin e burimeve të peshkimit, në përputhje me kreun VII/III të këtij ligji.

5. Nuk mund të krijohet më shumë se një organizatë menaxhimi peshkimi për një port ose një qendër peshkimi.

6. Procedurat për themelimin, organizimin dhe funksionimin e organizatës miratohen

nga ministri.

Neni 31/2

Anëtarësia në organizata
(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Anëtarësia në organizata është vullnetare dhe do të përbëhet nga anëtarë pronarë dhe anëtarë jopronarë.

2. Anëtar pronar ka të drejtë të bëhet mbajtësi i një licence profesionale për një mjet lundrues të regjistruar. Anëtar jopronar ka të drejtë të bëhet çdo kapiten aktiv, inxhinier apo peshkatar, që ka më shumë se dy vjet përvojë në veprimtarinë e peshkimit.

3. Tri të pestat e numrit të përgjithshëm të votave të anëtarëve do të caktohen për anëtarët pronarë të shoqatës, pjesa tjetër e votave do të jetë për anëtarët jopronarë.

Neni 31/3

Organet e organizatës
(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

Çdo organizatë ka asamblenë e përgjithshme, këshillin administrativ, si dhe organe të tjera të parashikuara në statut.

Neni 31/4

Asambleja e përgjithshme
(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Asambleja e përgjithshme është organi kryesor vendimmarrës i organizatës, që mbledhet të paktën një herë në vit në mbledhjen vjetore të përgjithshme.

2. Mbledhjet e jashtëzakonshme të asamblesë së përgjithshme mund të thirren nga këshilli administrativ, me vullnetin e tij ose në bazë të kërkesës me shkrim të atyre që kanë të paktën 10 për qind të numrit të përgjithshëm të votave ose sipas specifikimit në statut.

3. Asambleja e përgjithshme ka të drejtën ekskluzive të merret me çështjet e mëposhtme:

a) me miratimin e llogarive të raportit vjetor, buxhetit dhe planit të mirëmbajtjes dhe funksionimit;

b) me miratimin e shtesave të propozuara në statut, si dhe me rregulloret e brendshme dhe gjokat për shkeljen e tyre;

c) me zgjedhjen e këshillit administrativ;

ç) me vendimin për shpërndarjen e organizatës;

d) me çështje të tjera, që përcaktohen në statut.

4. Në rastin e anëtarëve pronarë që kanë më shumë se një barkë, statuti parashikon se nuk mund të ketë më shumë se 2/5 e votave që i përkasin anëtarëve jopronarë.

5. Një anëtar ka të drejtë të votojë në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme vetëm nëse ka paguar të gjitha detyrimet financiare ndaj organizatës.

Neni 31/5

Këshilli administrativ
(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Këshilli administrativ është organi përgjegjës për menaxhimin e organizatës dhe anëtarët e tij janë anëtarë të organizatës. Këshilli administrativ përgjigjet para asamblesë së

përgjithshme për mbikëqyrjen e veprimtarisë së organizatës dhe përbëhet të paktën nga tre anëtarë, njëri prej të cilëve është anëtar jopronar i organizatës.

2. Anëtarët e këshillit administrativ zgjidhen me votim të fshehtë në asamblenë e përgjithshme për një periudhë katërvjeçare. Një anëtar i këshillit administrativ, që ka përfunduar mandatin, mund të rikandidojë për t'u zgjedhur. Asnjë person nuk do të zgjidhet në këshillin administrativ nëse ka detyrime financiare ndaj organizatës.

3. Këshilli administrativ ka këto detyra:

- a) bën kërkesën për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme;
- b) përgatit projektbuxhetin, planin e punës, planin e përdorimit dhe të mirëmbajtjes, që miratohen nga asambleja e përgjithshme;
- c) nënshkruan kontratat në përputhje me buxhetin e miratuar, planin e punës dhe planin e përdorimit dhe të mirëmbajtjes;
- ç) cakton dhe shkarkon stafin e organizatës;
- d) përgatit axhendën e takimeve të asamblesë së përgjithshme;
- dh) harton rregulloret e brendshme të organizatës;
- e) monitoron punën e organizatës;
- ë) siguron ndjekjen e procedurave financiare dhe administrative të organizatës;
- f) çështje të tjera, siç përcaktohen në statut.

4. Mbledhjet e këshillit administrativ bëhen çdo muaj ose siç përcaktohet në statut, me kërkesë të kryetarit ose të 1/3 të anëtarëve të këshillit administrativ.

5. Nëse këshilli administrativ pezullohet në përputhje me pikën 3 të nenit 31/7 të këtij ligji, atëherë ministri emëron një drejtues të përkohshëm për të përmbushur detyrimet për mbarëvajtjen e punëve të organizatës deri në mbledhjen pasardhëse të asamblesë së përgjithshme, ku dhe emërohet këshilli i ri administrativ.

6. Drejtuesi i përkohshëm, përveç detyrimeve të përditshme sipas pikës 3 të këtij neni, thërret asamblenë e përgjithshme.

Neni 31/6

Statuti

(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Statuti i organizatës duhet të përmbajë të paktën:

- a) emrin dhe selinë e organizatës;
- b) rregullat e funksionimit të asamblesë së përgjithshme, të këshillit administrativ apo të organeve të tjera;
- c) të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të organizatës, të drejtën e votës, tarifat që do të paguhen nga anëtarët;
- ç) mënyrën e kontrollit të organizatës për veprimtarinë që kryen;
- d) dorëheqjen dhe përjashtimin e anëtarëve dhe sanksionet për shkeljen e statutit;
- dh) mënyrën e shpërndarjes dhe të likuidimit të organizatës.

2. Statuti mund të përmbajë edhe dispozita të tjera, të veçanta, për çdo organizatë, por, në çdo rast, pa tejkaluar objektivat e dhënë nga ligji.

3. Për ndryshimet në statut ndiqet e njëjta procedurë si për miratimin e tij.

Neni 31/7

Komiteti i Monitorimit

(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit krijohet Komiteti i Monitorimit, prej 7 vetash, i cili raporton te ministri për veprimtarinë e organizatave të menaxhimit të peshkimit

dhe të bashkëmenaxhimit të burimeve të peshkimit. Anëtarët e këtij komiteti janë punonjës të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit. Mënyra e funksionimit të këtij komiteti përcaktohet me rregullore të ministrit.

2. Çdo organizatë mban bilancet dhe regjistrat financiarë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe brenda 60 ditëve nga përfundimi i vitit financiar, depoziton kopje të tyre në Komitetin e Monitorimit.

3. Komiteti i Monitorimit, kur zbulon prova të shkeljeve financiare ose vëren se organizata nuk ka vepruar në përputhje me ligjin, njofton këshillin administrativ, i cili thërret menjëherë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, para së cilës paraqiten provat e gjetura nga Komiteti i Monitorimit. Nëse këshilli administrativ nuk e mbledh asamblenë e përgjithshme brenda 30 ditëve, Komiteti i Monitorimit pezullon këshillin administrativ.

Neni 31/8

Regjistri i organizatave

(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Ministria krijon regjistrin e organizatave. Rregullat për mbajtjen e regjistrit dhe konsultimin e tij nga publiku përcaktohen nga ministri.

2. Regjistri duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin e organizatës;
- b) selinë qendrore të organizatës;
- c) numrin e anëtarëve të organizatës;
- ç) emrat, adresat dhe numrat telefonikë të anëtarëve të këshillit administrativ dhe të kryetarit të çdo organizate;
- d) datën e arkivimit të bilancit të fundit vjetor, së bashku me një kopje të tij.

Neni 31/9

Kontrolli i veprimtarisë së organizatës

(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

Veprimtaria e organizatës dhe dokumentet e saj kontrollohen nga organet e specializuara të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, si dhe nga organe të tjera, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 31/10

Shpërndarja e organizatës

(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Organizata shpërndahet me urdhër të ministrit në rastet e mëposhtme:

a) Kur propozohet nga vetë asambleja e përgjithshme. Në këtë rast vendimi i asamblesë së përgjithshme merret me 2/3 e votave të anëtarëve të organizatës.

b) Kur organet e kontrollit vërejnë se organizata i është shmangur qëllimit për të cilin është krijuar ose nuk është në gjendje të plotësojë, në praktikë, detyrat.

2. Ministri i jep 30 ditë afat organizatës për zgjidhjen e problemeve të vëna re, para se të ushtrojë të drejtën, në përputhje me shkronjën "b" të pikës 1 të këtij neni. Urdhri për shpërndarjen e organizatës botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Me urdhrin për shpërndarje, organizata ndërpret veprimtarinë dhe likuidohet nga komisioni i likuidimeve, i cili krijohet dhe vepron sipas rregullave të përcaktuara në statutin tip.

4. Kundër urdhrorit të ministrit për shpërndarjen, organizata ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes së urdhrorit.

KREU VII/II
DHËNIA NË PËRDORIM E PORTEVE, E QENDRAVE TË PESHKIMIT DHE E
STRUKTURAVE QË USHTROJNË VEPRIMTARI PESHKIMI
(Shtuar Kreu me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

Neni 31/11

Transferimi i porteve dhe i qendrave të peshkimit
(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Një port ose qendër peshkimi dhe strukturat e lidhura me veprimtarinë e peshkimit mund t'i transferohen në administrim një organizate me kërkesën e saj.

2. Kalimi në përdorim i një porti ose qendre peshkimi ose dhe i strukturave të lidhura me veprimtarinë e peshkimit, te një organizatë e menaxhimit të peshkimit do të bëhet sipas kriterëve të mëposhtme:

- a) mosndryshimin e destinacionit dhe të qëllimit;
- b) garantimin e përdorimit të portit ose qendrës së peshkimit nga ana e shtetit në rastet e masave të jashtëzakonshme;
- c) ruajtjen dhe garantimin e interesit publik;
- ç) ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike.

3. Format e marrëveshjeve, së bashku me kushtet e përdorimit të porteve ose të qendrave të peshkimit dhe të strukturave të lidhura me veprimtarinë e peshkimit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Organet shtetërore, të ngarkuara nga ligji, kanë të drejtë të inspektojnë infrastrukturën e transferuar, sipas dispozitave të këtij ligji, si dhe dokumentacionin përkatës.

Neni 31/12

Përdorimi i porteve dhe i qendrave të peshkimit nga organizata
(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

Një organizatë përdor dhe mirëmban portet ose qendrat e peshkimit që i janë transferuar, në përputhje me parimet e mëposhtme:

- a) administruesit e portit ose të qendrës së peshkimit duhet të përballojnë kostot e përdorimit dhe të mirëmbajtjes;
- b) porti ose qendra e peshkimit përdoren në mënyrë të drejtë e të barabartë për të nxitur dhe mbrojtur interesat e përdoruesve;
- c) porti ose qendra e peshkimit administrohen në një mënyrë racionale, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, për të nxitur mbrojtjen e mjedisit dhe një zhvillim të qëndrueshëm.

Neni 31/13

Përdorimi i portit ose i qendrës së peshkimit nga persona joanëtarë të organizatës
(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Një organizatë është e detyruar të lejojë:

a) çdo mjet lundrues, që është pronë ose drejtohet nga një person, i cili nuk është anëtar i organizatës, të përdorë portin ose qendrën e peshkimit që i është transferuar Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit;

b) personat, të cilët nuk janë anëtarë të organizatës, të hyjnë në port ose në qendrën e

peshkimit.

2. Çdo person, i cili hyn ose shfrytëzon portin ose qendrën e peshkimit, që i është transferuar një organizate dhe që nuk është anëtar i saj, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e portit ose të qendrës së peshkimit, dhe me rregulloret e organizatës.

3. Tarifat që organizata ofron për shërbimet për një mjet lundrues, që është pronë a drejtohet nga një person, i cili nuk është anëtar i organizatës, janë më të larta se tarifat për mjetet lundruese të anëtarëve të saj, por, në çdo rast, jo më shumë se dyfishi.

4. Niveli i tarifave propozohet nga organizata dhe miratohet nga ministri.

KREU VII/III
BASHKËMENAXHIMI I PESHKIMIT
(Shtuar Kreu me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

Neni 31/14
Përcaktimi i një zone bashkëmenaxhuese
(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Si zonë bashkëmenaxhuese e peshkimit miratohet nga ministri çdo hapësirë gjeografike e caktuar e ujërave të Republikës së Shqipërisë, në bazë të kërkesës me shkrim të organizatës. Zona e bashkëmenaxhimit mund të shtrihet për të gjitha veprimtaritë e peshkimit brenda saj ose vetëm në veprimtaritë e peshkimit që përdorin teknika ose mjete gjuetie specifike dhe/ose në periudha të caktuara të vitit.

2. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, e lidhur me një zonë bashkëmenaxhuese, përfshihet në përgatitjen dhe zbatimin e planit të bashkëmenaxhimit për zonën përkatëse.

Neni 31/15
Planet e bashkëmenaxhimit
(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Çdo plan bashkëmenaxhimi miratohet për një periudhë jo më shumë se dhjetë vjet dhe ka si qëllim:

a) të nxisë përdorimin e burimeve të peshkimit mbi bazën e zhvillimit të qëndrueshëm, duke siguruar, në të njëjtën kohë, mirëmbajtjen e tyre në nivele që arrijnë të plotësojnë nevojat sot dhe në të ardhmen;

b) të mirëmbajë e të ruajë cilësinë dhe llojshmërinë biologjike të burimeve të peshkimit;

c) të nxisë zbatimin e teknologjisë së përshtatshme për peshkim;

ç) të shmangë tejkalimin e kapacitetit të peshkimit.

2. Brenda dymbëdhjetë muajve nga data e caktimit të zonës bashkëmenaxhuese, organizata përkatëse dhe Drejtoria e Peshkimit përgatisin planin e bashkëmenaxhimit të peshkimit për këtë zonë, i cili miratohet nga ministri.

3. Projektplanet e bashkëmenaxhimit hartohen nga Drejtoria e Peshkimit dhe organizata përkatëse, sipas rregulloreve që lëshohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe komisionet e këshillimeve vendore për peshkimin dhe akuakulturën.

4. Planet bashkëmenaxhuese, pas nënshkrimit, botohen në Fletoren Zyrtare, si dhe publikohen në një gazetë që qarkullon në ose pranë zonës bashkëmenaxhuese.

Neni 31/16

Përmbajtja e planit të bashkëmenaxhimit

(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Çdo plan bashkëmenaxhimi duhet:
 - a) të përmbajë një analizë të gjendjes së peshkimit në zonën e bashkëmenaxhimit;
 - b) të identifikojë objektivat afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë që duhen realizuar, për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm dhe të frytshëm të peshkimit në zonën e bashkëmenaxhimit;
 - c) të përcaktojë masat e rekomanduara të menaxhimit dhe strategjitë e zhvillimit, të nevojshme për të arritur këta objektiva;
 - d) të identifikojë burimet e financimit për kostot e zbatimit të këtyre masave menaxhuese;
 - dh) të përmbajë matës dhe mekanizma zyrtarë kontrolli, në mënyrë që të vlerësohet zbatimi, rregullimi dhe frytshmëria e tij;
 - e) të përputhet me planin kombëtar për menaxhimin e peshkimit.
2. Një plan bashkëmenaxhimi, që lidhet me një zonë bashkëmenaxhimi, ku përfshihen dy a më shumë organizata, duhet të pasqyrojë me hollësi mekanizmat e bashkëpunimit ndërmjet këtyre organizatave.

Neni 31/17

Veprimtaria e peshkimit në zonën bashkëmenaxhuese

(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Aty ku është e nevojshme që të nxitet një menaxhim i frytshëm i peshkimit, plani i bashkëmenaxhimit siguron që:
 - a) asnjë person të mos ndërmarrë veprimtari peshkimi ose peshkimi profesional në territorin e zonës bashkëmenaxhuese, nëse ai nuk është anëtar i organizatës përkatëse bashkëmenaxhuese;
 - b) asnjë person të mos ndërmarrë veprimtari peshkimi me pajisje ose teknika të veçanta, nëse ai nuk është anëtar i organizatës përkatëse bashkëmenaxhuese.
2. Për rastet e përmendura në pikën 1:
 - a) Mbajtësit e licencave të peshkimit profesional do të vazhdojnë të kenë të drejtën për të kryer veprimtari peshkimi për një periudhë deri në një vit pas hyrjes në fuqi të planit të bashkëmenaxhimit.

Pas kësaj periudhe ata duhet të bëhen anëtarë pronarë ose të ndërpresin veprimtarinë e peshkimit në zonën e bashkëmenaxhimit.
 - b) Anëtarët pronarë të rinj që, me hyrjen në fuqi të ligjit, nuk janë mbajtës të licencave të peshkimit profesional, do të pranohen në organizatë në bazë të kriterëve të përcaktuara deri në kapacitetin e parashikuar dhe në përputhje me planin e bashkëmenaxhimit.

Neni 31/18

Licencimi në një zonë bashkëmenaxhuese

(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

Një plan bashkëmenaxhimi siguron që dispozitat e nenit 15 të veprojnë në zonën bashkëmenaxhuese ku ai shtrihet dhe, gjithashtu, përcakton sa dhe si organizata ose organizatat përkatëse do të përfshihen në dhënien dhe zbatimin e licencave.

Neni 31/19
Monitorimi dhe rishikimi
(Shtuar me ligjin nr. 8870, 21.3.2002)

1. Komisioni për koordinimin e kërkimit shkencor dhe teknologjik mund të kërkojë në çdo kohë një rishikim të zbatimit të çdo plani për bashkëmenaxhimin e peshkimit, në rast se:
 - a) plani nuk është zbatuar saktë dhe me frytshmëri;
 - b) zbatimi i planit kërcënon burimet e peshkimit në zonën bashkëmenaxhuese;
 - c) shkakton konflikte serioze ndërmjet anëtarëve.
2. Ministri, kur shikon se rrezikohen dhe dëmtohen rezervat e peshkimit dhe/ose zonat ujore:
 - a) urdhëron modifikimin e planit ekzistues të bashkëmenaxhimit dhe/ose mënyrën e zbatimit të tij dhe/ose të detyrimit për zbatim;
 - b) urdhëron marrjen e masave të veçanta, për zbatimin ose detyrimin në zbatim të planit ekzistues të bashkëmenaxhimit;
 - c) ndërpret zbatimin e planit ekzistues të bashkëmenaxhimit;
 - ç) hedh poshtë planin ekzistues të bashkëmenaxhimit.
3. Në rast se një plan bashkëmenaxhimi ndërpritet ose hidhet poshtë, ministri përcakton, në të njëjtën kohë, regjimin e menaxhimit, që zbatohet për këtë lloj peshkimi, dhe nxjerr rregulla të tjera për zbatim.

KREU VIII
KOMPETENCA TË TJERA TË MINISTRISË

Neni 32
Rregulloret
(Shtuar shkronjat “p”, “q”, “r”, “rr”, “s”, “sh” me ligjin nr. 8870, 21.3.2002;
ndryshuar shkronjat “ë”, “f” e “j” me ligjin nr. 10 001, datë 6.10.2008)

- Ministria harton, përshtat e miraton rregullore për zbatimin e këtij ligji, të cilat përfshijnë:
- a) përbërjen, funksionimin dhe detyra të veçanta të organeve konsultative që krijohen në bazë të neneve 4, 6 e 7 të këtij ligji;
 - b) modelet e kërkesës, të autorizimit dhe të licencës, të parashikuara nga ky ligj;
 - c) kushtet për lëshimin dhe rinovimin e autorizimeve të kërkimit;
 - ç) kriteret dhe mënyrat për njohjen e enteve kërkimore sipas nenit 10 të këtij ligji;
 - d) kushtet, kërkesat dhe mënyrat e regjistrimit në regjistër e peshkatarëve sipas nenit 12 të këtij ligji, si dhe modelin e regjistrit dhe normat për mbajtjen e tij;
 - dh) kualifikimet dhe tituj profesionalë të personelit të punësuar në peshkim e akuakulturë, si dhe kriteret dhe mënyrat e regjistrimit të tyre;
 - e) kushtet, kërkesat dhe mënyrat e regjistrimit të anijeve të peshkimit sipas nenit 16 të këtij ligji;
 - ë) kushtet për lëshimin dhe rinovimin e licencave të peshkimit profesional;
 - f) krijimin dhe mbajtjen pranë ministrisë të arkivit të licencave të peshkimit;
 - g) detyrimet dhe mënyrat e paraqitjes së relacioneve nga titullarët e autorizimeve të kërkimit;
 - gj) detyrimet dhe mënyrat e paraqitjes së informacioneve dhe të dhënave statistikore për peshkimin e akuakulturës, si dhe për shfrytëzimin ekonomik të prodhimeve të peshkimit e akuakulturës;
 - h) ndalimet në peshkim sipas nenit 24 ose ndalime të tjera, duke parashikuar edhe

sanksione në bazë të ligjit;

i) ndërprerjen, anulimin, rinovimin ose refuzimin për rinovimin e licencave dhe autorizimeve të parashikura nga ky ligj;

j) peshkimin sportiv e, në veçanti, llojet, pajisjet, zonat, periudhat, ushtrimin e kësaj veprimtarie në ujërat e brendshme, përdorimin e mjeteve lundruese, kushtet për përdorimin e pushkës nënujore.

k) taksat për licencat dhe autorizimet e parashikuara në bazë të këtij ligji;

l) kushtet higjieniko-shëndetësore në lidhje me organizmat ujorë të peshkuar ose të prodhuar nga veprimtaria e akuakulturës;

ll) sasitë minimale vjetore që do të peshkohen nga subjektet si kusht për rinovimin e licencës;

m) të ushtruarit e akuakulturës, e në veçanti:

- strukturat, pajisjet, impiantet dhe mirëmbajtjen;

- metodat e kultivimit;

- grumbullimin e të dhënave për akuakulturën;

- kontrollin e impianteve dhe të mjedisit;

- vendosjen gjeografike të impianteve;

- kreditë lehtësuese;

- eksportin dhe importin e të vegjëlve;

- taksat për marrjen me qira të zonave ujore të Republikës së Shqipërisë dhe kushte të tjera;

- taksat për marrjen me qira të tokave shtetërore dhe kushte të tjera;

n) organizimin e tregjeve të peshkut e në veçanti detyrimin për të paraqitur të dhënat statistikore për veprimtarinë e zhvilluar;

nj) autorizimin e organeve administrative ose enteve të tjera për lëshimin e licencave të parashikuara në këtë ligj;

o) emërimin dhe kompetencat e inspektorëve të peshkimit

p) redaktimin e procesverbaleve nga ana e inspektorëve të peshkimit dhe modularët përkatës;

q) procedurat për themelimin e organizatës, përfshirë format dhe përmbajtjen e statuteve;

r) librat, regjistrat që mbahen nga organizatat dhe procedurat financiare;

rr) puna e Komitetit të Monitorimit dhe procedurat e kontrollit;

s) krijimi dhe funksionimi i Komitetit të Monitorimit, përfshirë mbajtjen e regjistrave të organizatave të menaxhimit të peshkimit dhe procedurat e kontrollit që do të ndiqen;

sh) mënyra e përdorimit të porteve dhe e qendrave të peshkimit, që u janë transferuar organizatave.

Neni 33

Kualifikimi profesional

1. Ministria jep mendimin e vet për përshtatjen dhe zbatimin e programeve në lëmin e disiplinave të zbatuara në peshkim dhe akuakulturë, që zhvillohen në shkolla ose në kurse të ndryshme kualifikimi.

2. Ministria, në bashkëpunim me Komisionin për koordinimin e kërkimit shkencor e teknologjik, kujdeset që të krijohen kurse në lëmin e peshkimit e akuakulturës për kualifikimin dhe formimin profesional.

KREU IX KONTROLLI

Neni 34 **Organet e kontrollit**

Kontrolli për zbatimin e këtij ligji e të rregulloreve që rrjedhin prej tij, ushtrohet nga Inspektorati i peshkimit, sipas nenit 36 të këtij ligji. Bashkëpunojnë për këtë qëllim Inspektorati i mbrojtjes së mjedisit, policia e rendit e financiare, kapiteneritë e porteve, Forcat e Armatosura dhe çdo organ tjetër që ngarkohet nga qeveria.

Neni 35 **Bashkërendimi**

Ministria e bashkërendon veprimtarinë e organeve të kontrollit mbi peshkimin dhe akuakulturën.

Neni 36 **Inspektorati i peshkimit**

1. Krijohet Inspektorati i peshkimit, i cili është organi përgjegjës e kompetent për kontrollin e zbatimit të këtij ligji e të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.
2. Inspektorati i peshkimit krijohet pranë ministrisë, si sektor brenda Drejtorisë së peshkimit dhe ka zyra në vende të ndryshme, ku shihet e nevojshme, me qëllim që të sigurojë zbatimin e këtij ligji e të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.
3. Struktura dhe organizimi i Inspektoratit të peshkimit përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, në bazë të propozimit të bërë nga ministria.
4. Emërimi i çdo inspektori të peshkimit bëhet nga ministri, mbi bazën e propozimit të Drejtorisë së peshkimit.
5. Kompetencat e inspektorëve të peshkimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Ministri mund të autorizojë funksionarë të veçantë të Drejtorisë së peshkimit për të kryer funksionet e inspektorëve të peshkimit.

Neni 37 **Detyrat dhe të drejtat e inspektorëve të peshkimit**

Inspektorët e peshkimit, sa herë që vërejnë shkelje të këtij ligji dhe të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, kanë detyrë dhe të drejtë të:

- a) ndalojnë fajtorin dhe eventualisht anijen, me të cilën është konstatuar shkelja, si dhe të kontestojnë shkeljen;
- b) kërkojnë shkelësit gjeneralitetet;
- c) përpilojnë procesverbalin, duke treguar gjeneralitetet e atij që ka kryer shkeljen, dispozitat e shkelura, sendet që eventualisht konfiskohen sipas pikës (f), licencën ose autorizimin e ndërprerë sipas pikës (g) mundësisht menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga konstatimi i faktit;
- d) ndalojnë e çojnë menjëherë në postën më të afërt të policisë personat e ndaluar, në rast se refuzojnë të japin gjeneralitetet e tyre ose kur dyshohet se ato janë të pasakta, si dhe në rastet kur shkelja përbën vepër penale;
- e) në rastet kur shkelja përbën vepër penale, të bëjnë kallëzim në organet gjyqësore;

f) sekuestrojnë sendet e përdorura për kryerjen e shkeljes, ose që janë pasojë e shkeljes, në çdo rast sipas dispozitave ligjore që lejojnë organet e policisë për sekuestrim, deri në momentin e vendimit të Komisionit (neni 43);

g) ndërpresin vlefshmërinë e licencës ose autorizimit të lëshuar në bazë të këtij ligji, deri në vendimin që do të merret nga Komisioni për këtë shkelje (neni 45).

Neni 38

Inspektimi dhe kërkesa e informacionit

1. Inspektorët e peshkimit në çdo moment mund të inspektojnë mjetet lundruese, impiantet, stabilimentet dhe ekonomitë e peshkimit e të akuakulturës, vendet e depozitimit dhe të shitjes, mjetet e transportit të prodhimeve peshkore dhe pajisjet e peshkimit e t'i kërkojnë kujtdo informacionin që lidhet me këto, e së fundi të sqarojnë respektimin e normave për disiplinën e peshkimit dhe të akuakulturës.

2. Inspektorët e peshkimit në çdo moment mund t'i kërkojnë paraqitjen e licencës ose të autorizimit të lëshuar mbi bazën e këtij ligji e të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, cilitdo që zhvillon një veprimtari, për të cilin këto licenca e autorizime janë të domosdoshme në bazë të këtij ligji.

KREU X

KUNDËRVAJTJET, SANKSIONET DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 39

Kundërvajtjet administrative

(Ndryshuar pikat 14, 17 dhe fjalë në pikën 18, hequr fjalë në pikën 16, shfuqizuar pika 19 me ligjin nr. 10 001, datë 6.10.2008)

A) 1. Cilido që zhvillon veprimtari kërkimore pa autorizimin sipas nenit 10, ose në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në autorizim, dënohet me gjobë nga 100 mijë deri në 300 mijë lekë.

2. Cilido që ushtron peshkimin profesional pa qenë i regjistruar në regjistër sipas nenit 12, dënohet me gjobë nga 10 mijë deri në 50 mijë lekë.

3. Kur një mjet lundrues përdoret për peshkim profesional pa qenë e regjistruar në regjistrin e mjeteve lundruese të peshkimit sipas nenit 13, pronari ose kapiteni i mjetit lundrues dënohet me gjobë nga 50 mijë deri në 200 mijë lekë.

4. Cilido që ushtron peshkim profesional pa mjete lundruese dhe nuk është i pajisur me licencë sipas nenit 15, dënohet me gjobë nga 100 mijë deri në 1 milion lekë.

5. Kur një mjet lundrues shqiptar përdoret për veprimtari të peshkimit profesional me metodën artizanale, pa qenë i pajisur me licencë sipas nenit 15, pronari ose kapiteni imjetit lundrues dënohet me gjobë nga 100 mijë deri në 1 milion lekë.

6. Kur një mjet lundrues shqiptar përdoret për peshkim profesional me metodën industriale, pa qenë i pajisur me licencë sipas nenit 18 pronari ose kapiteni i mjetit luundrues dënohet me gjobë nga 5 milionë deri në 10 milionë lekë.

7. Cilido që ushtron peshkimin profesional në kundërshtim me kushtet e parashikuara në licencë, dënohet me gjobë nga 500 mijë deri në 1 milionë lekë.

8. Cilido që peshkon:

a) në zona e periudha të ndaluara nga aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji;

b) me mjete lundruese, pajisje fikse ose të lëvizhme, të ndaluara nga aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

c) organizma ujorë të llojeve të ndryshme, të ndaluara nga aktet nënligjore për zbatimin

e këtij ligji;

ç) organizma ujorë të përmasave të ndaluara nga aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji;

d) në sasi më të mëdha se ato të fiksuara si sasi maksimale nga aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji ose nga licenca e lëshuar;

dh) duke përdorur pajisje nënujore të ndaluara - dënohet me gjobë nga 100 mijë deri në 3 milionë lekë.

9. Cilido që peshkon vetë, larva e të vegjël të çfarëdo organizmi ujor, pa qenë i pajisur me autorizim, dënohet me gjobë nga 100 mijë deri në 2 milionë lekë.

10. Cilido që përvetëson prodhimin e peshkimit të të tretëve ose në ndonjë mënyrë tjetër shkel dispozitat e nenit 24, pika c, dënohet me gjobë nga 5 mijë deri në 10 mijë lekë.

12. Cilido që ndryshon cilësinë e ujërave ose drejtimin e rrjedhës së tyre në mënyrë të tillë që dëmton habitatin e organizmave ujorë, përveç autorizimit në bazë të ligjit, dënohet me gjobë nga 100 mijë deri në 2 milionë lekë.

13. Cilido që peshkon korale e sfungjerë, dënohet me gjobë nga 15 milionë deri në 20 milionë lekë dhe në konfiskimin e mjetit lundrues.

14. Cilido, që zhvillon veprimtari peshkimi sportiv, me përdorim të një mjeti lundrues, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 23 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 5 mijë deri në 10 mijë lekë.

15. Cilido që i jep një pushkë nënujore një personi nën moshën 16 vjeçare për të peshkuar, dënohet me gjobë nga 5 mijë deri në 10 mijë lekë.

16. Cilido titullar licence të peshkimit profesional që kundërshton të paraqesë informacionet që kërkohen në bazë të këtij ligji e të akteve nënligjore për zbatimin e tij ose paraqet informacione joreale e të pasakta, dënohet me gjobë nga 10 mijë deri në 50 mijë lekë.

17. Cilido, që zhvillon veprimtari akuakulture në kundërshtim me nenin 27 të këtij ligji dënohet me gjobë:

i) 50 mijë lekë, nëse kapacitetet prodhuese janë deri në 30 tonë peshk;

ii) 100 mijë lekë, nëse kapacitetet prodhuese janë deri në 50 tonë peshk;

iii) 500 mijë lekë, nëse kapacitetet prodhuese janë mbi 50 tonë peshk.

18. Kur një anije e huaj zhvillon veprimtarinë e peshkimit në ujërat e Republikës së Shqipërisë pa qenë i pajisur me licencë sipas nenit 19, ose në kundërshtim me kushtet e licencës, pronari ose kapiteni i anijes dënohet me gjobë nga 25 milionë deri në 40 milionë lekë.

19. Shfuqizuar.

20. Cilido që nuk pranon a pengon inspektimet nga ana e organeve të kontrollit sipas nenit 34 ose kundërshton t'u paraqesë organeve të kontrollit licencat ose autorizimet e kërkuara në bazë të këtij ligji e të akteve nënligjore për zbatimin e tij, dënohet me gjobë nga 100 mijë deri në 500 mijë lekë.

B) Cilido që përdor lëndë plasëse, kimike e helmuese, energji elektrike të afta të trullosin, paralizojnë ose vrasin peshqit e organizmat e tjerë ujorë, si dhe grumbullon, transporton e tregton këto lloj prodhimesh, dënohet sips dispozitave të Kodit Penal.

Neni 40

Sanksione plotësuese

Për shkeljet e mësipërme të ligjit zbatohen edhe këto sanksione plotësuese:

a) konfiskimi i produkteve të peshkuara, me përjashtim të rastit kur kjo është kërkuar nga përfituesi sipas ligjit;

b) konfiskimi i mjeteve dhe pajisjeve të përdorura në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji e akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, si dhe konfiskimi i anijes e mjetit tjetër lundrues;

c) ndërprerja e licencës ose e autorizimit të lëshuar në bazë të këtij ligji e të rregullave

për zbatimin e tij për një periudhë jo më të gjatë se 6 muaj, e në rast përsëritjeje të së njëjtës kundërvajtje, deri në ndërprerjen e përhershme të tyre.

ç) çregjistrimi nga regjistri i peshkatarëve për një periudhë jo më të gjatë se 6 muaj, ose në rast përsëritje të së njëjtës kundërvajtje, deri në ndërprerjen e përhershme të tij;

d) në rastet e enteve të njohura të kërimit, u hiqet statusi i institucionit të njohur të kërimit.

Neni 41

Zhdëmtimi

1. E drejta për zhdëmtimin e dëmeve të shkaktuara në rastet e shkeljeve të këtij ligji përcaktohet mbi bazën e ligjeve në fuqi.

2. Për kundërvajtjet e parashikuara nga ky ligj, shteti i përfaqësuar nga ministri ka të drejtën të kërkojë zhdëmtimin e dëmit.

Neni 42

Përgjegjësia civile

Pronari i anijes, sipërmarrësi, kapiteni i anijes ose subjekti i peshkimit dhe akuakulturës janë personalisht e juridikisht përgjegjës për gjrobat dhe sanksionet administrative të vendosura ndaj ndihmësve e vartësve të tyre për shkeljet e këtij ligji.

Neni 43

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative

1. Për të marrë vendimet pas shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative sipas nenit 39 dhe të sanksioneve plotësuese sipas nenit 40, ministri krijon një komision të përhershëm pranë ministrisë.

2. Komisioni përbëhet nga një numër tek personash dhe merr vendime me shumicë votash, pas shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative sipas këtij ligji ose akteve nënligjore për zbatimin e tij, si dhe për zbatimin e sanksioneve plotësuese.

3. Komisioni thërret, me njoftim paraprak, personat fajtorë për kryerjen e kundërvajtjes në bazë të procesverbalit sipas nenit 37. Procedura e gjykimit para komisionit zhvillohet në bazë të ligjit në fuqi “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 44

Ankimi në gjykatë

Kundër çdo dënimi të dhënë nga komisioni sipas nenit 43 mund të bëhet ankim në gjykatë.

KREU XI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 45

Shfuqizimet

Neni nr. 6071, datë 25.12.1979 “Për ekonominë e peshkimit”, shfuqizohet, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 46
Dispozita të përkohshme

Ministria, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë një rregullore për zbatimin e tij.

Neni 47

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 1066, datë 18.4. 1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**